



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:208742

Datë: 25.06.2024

Numri i dokumentit: 05855546

Ac.nr.3163/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Fatmir Baloku-Kryetar, Kujtim Pasuli dhe Dardan Kadolli-anëtarë, në çështjen juridiko-civile kontestimore të paditësve, S, R, N dhe S.Z, të gjithë nga Prishtina, të cilët i përfaqëson Zh.G, avokat në Graçanicë, kundër të paditurës Qeveria e Përkohshme e Kosovës me seli ne Prishtinë, për kompensimin e dëmit, vlera e kontestit 150.000 euro, duke vendosur sipas ankesës së ushtruar nga i autorizuari i paditësve, kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2525/19, të datës 29.10.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 19.06.2024, nxjerr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET SI E PA BAZUAR ankesa e paditësve S, R, N dhe S.Z, të gjithë nga Prishtina, e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2525/19, të datës 29.10.2019, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.2525/19, i datës 29.10.2019, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e ankimuar, C.nr.2525/19, të datës 29.10.2019, ka vendosur si në vijim:

I. REFUZOHET NË TËRËSI SI E PABAZUAR kërkesëpadia e paditësve, S, R, N dhe S.Z, të gjithë nga Prishtina, kundër të paditurës Qeveria e Përkohshme e Kosovës me seli ne Prishtinë, me cilin kanë kërkuar që paditësit S.Z, në emër të dëmit material t’ia paguaj:

- Për dhimbje fizike, shumën prej.....150,000 euro
- Për dhimbje shpirtërore, për zvogëlimin e aktivitetit jetësor, shumën prej 250000 euro
- Për dhimbje shpirtërore dhe dëmtimit, shumën prej..... 250000 euro
- Për frikën e shkaktuar shumën prej 150000 euro apo shumën e tërësishme prej 800000 euro.

Paditësve R, N dhe S:

- Për durimin e dhimbjeve fizike, për secilin nga..... 250000 euro
- Për frikën për shok të pësuar për shkak të ndjenjave të lënduara shumën prej 1500000 euro. Si dhe TË DETYROHEN të paditurit që paditësit ti paguajnë të gjitha shpenzime të procedurës, e të gjitha këto në afat prej 15 ditë, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi. II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi ankesë kanë parashtruar paditësit përmes të autorizuarit te tyre, për shkak të Shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, nga neni 182 par.1 dhe 182 par.2 pika i) dhe j) të LPK-së dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që

të ndryshohet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe të aprovohet kërkesëpadia e paditësve apo aktgjykimi të priset dhe çështja ti kthehet gjykatës së shkallës së parë në rivendosje.

E paditura nuk ka dhënë përgjigje në ankesën e të paditurit, edhe pse të njëjtës ankesa iu është dorëzuar.

Gjykata e Apelit pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, aktgjykimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 194,195 dhe 200 të LPK-së gjeti se:

Ankesa e paditësve është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësit fillimisht kanë ushtruar padi kundër të paditurave U.N.M.I.K- K.F.O.R dhe Qeveria e Përkohshme e Kosovës, për kompensim dëmi.

Gjykata e shkallës së parë me aktvendimin C.nr.68/04 të datës 26.02.2013 e ka hedhë poshtë si të palejuar padinë e paditësve.

Kundër këtij aktvendimi paditësit kanë parashtruar ankesë në Gjykatën e Apelit.

Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.1824/19 të datës 05.06.2019 pjesërisht ka prishë aktvendimin e gjykatës së shkallës së parë në pjesën që ka të bëjë me Qeverinë e Përkohshme të Kosovës.

Gjykata e shkallës së parë në riprocedurë ka vendosur që kërkesëpadinë e paditësve ta refuzoj si të pabazuar duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Ndërsa në arsyetim ka theksuar se: gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave prezente në lëndë deklarimeve të të autorizuarve të palëve ndërgjyqëse, e duke u mbështetur në dispozitat të nenit 4.2, 5, 17, 18, 73, 76, 321.1, 387, 391.1, pika a, 399.1 dhe 2, të Ligjit për Procedurën Kontestimore me nr. 03/L-006, Rezolutës 1244, të Këshillit të Sigurimit, të Kombeve të Bashkuara, e miratuar me dt. 10 qershor 1999, Marrëveshjes Teknike Ushtarake të Kumanovës, të dt. 09.06.1999, nenit 1 të Rregullores së UNMIK-ut 1999/1 të dt. 25. korrik 1999, nenit 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/45, e cila ka hyrë në fuqi me dt. 11. gusht 2000, mbi Vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, nenit 2, të Rregullores së UNMIK-ut, me nr. 2000/47, për Statusin Privilegjet dhe Imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut, dhe personelit të tyre, vendosi si në pikën 1, të dispozitivit të këtij aktgjykimit. Gjykata vendosi si në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi për arsye se të paditurit Qeveria e Përkohshme e Kosovës i mungon legjitimiteti pasiv në këtë çështje juridike, për shkak të Rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, e miratuar nga Këshilli i Sigurimit me dt. 10. qershor 1999, në pikën 7 të kësaj Rezolute, i autorizon vendet anëtare dhe organizatat relevante ndërkombëtare për të vendosur një prani ndërkombëtare të sigurisë në Kosovë, ashtu sikur të parashtrohet në pikën 4, të aneksit 2, me të gjitha mjetet të nevojshme për ti plotësuar detyrat e veta të theksuar në paragrafin 9 të kësaj rezolute, ashtu që obligimet të forcave ndërkombëtare të sigurisë të cilat do të vendosën dhe që do të veprojnë në Kosovë, do të garantojnë sigurinë dhe rendin publik, deri në momentin kur prania ndërkombëtare civile mund të merr përgjegjësinë lidhur me këtë, po ashtu në paragrafin 10 të kësaj rezolute, këshilli i sigurimit e autorizon sekretarin e përgjithshëm, që me ndihmën e organizatave të tjera ndërkombëtare të vendos një prani ndërkombëtare civile në Kosovë, për sigurimin e një administrate kalimtarë për Kosovën, si dhe një administratë kalimtare për themelimin dhe mbikëqyrjen e institucioneve të përkohshme demokratike dhe vetëqeverisëse, për të siguruar kushte për një jetë normale dhe të qetë për të gjithë banorët e

Kosovës, në paragrafin 11 të kësaj rezolute janë përcaktuar detyrat themelore të pranisë ndërkombëtare civile në Kosovë, që i referohen vendosjes në Kosovë, të pranisë ndërkombëtare civile dhe të sigurisë të miratuara nga Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara, si dhe krijimi i një administratë kalimtare për Kosovën e cila do të vendosët nga Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, në mënyrë që të sigurohet një jetë, në paçe dhe normale për të gjithë qytetarët të Kosovës. Gjykata vendosi si në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi për arsye së për dëmin e shkaktuar sikur pretendon pala paditëse nuk përgjigjët Qeveria e Përkohshme Kosovës, për arsye se çështja e sigurisë së jetës dhe pasurisë në Kosovë, ishte nën kompetencat e UNMIK-ut dhe të KFOR-it, kjo në bazë të Marrëveshjes Teknike Ushtarake të Kumanovës, e cila është pjesë përbërëse e Rezolutës së Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, nën nenin 1 dhe 2, shprehimisht parashihet së përgjegjësinë për sigurinë dhe administrim civil në Kosovë, do ta marrin UNMIK-u dhe KFOR-i. Gjykata vendosi si në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimit duke u mbështetur edhe në dispozitat të nenit 1, të Rregullores së UNMIK-ut 1999/1 të dt. 25. korrik 1999, e cila shprehimisht parasheh së kompetenca legislative dhe ekzekutive që ka të bëjë me Kosovën, duke përfshirë edhe administrimin e gjykatave, e ka UNMIK-u, dhe këtë pushtet e ushtron Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm i Këshillit të Sigurimit. Gjykata vendosi si në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimit duke u mbështetur edhe në dispozitat të nenit 1.1 të Rregullores së UNMIK-ut me nr. 2000/45, e cila ka hyr në fuqi me dt. 11. gusht 2000, mbi vetëqeverisjen e Komunave të Kosovës, e cila shprehimisht parasheh se deri në vendimin e statusit të ardhshëm të Kosovës, në pajtim me rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, si pas kësaj Rregullore themelohen institucionet e përkohshme për vetëqeverisje autonome dhe demokratike në nivel komunal si hap drejt bartjes progresive të përgjegjësiive administrative të UNMIK-ut, i cili do të mbikëqyrë dhe ndihmon në konsolidimin e këtyre institucioneve. Gjykata vendosi si në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi duke refuzuar kërkesë padinë e palës paditëse në raport me të paditurat Qeveria e Përkohshme e Kosovës në mungesë të legjitimitetit pasiv për arsye së në kohën e shkaktimit të dëmit siç pretendon pala paditëse Qeveria e Kosovës, nuk përgjigjët për dëmin e shkaktuar për arsye së çështja e sigurimit të jetës dhe të pasurisë në momentin e shkaktimit të dëmit ka qenë nën kompetencat të UNMIK-ut dhe KFOR-it, dhe së pushtetit lokal është administruar nga misioni i administratës së përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, (UNMIK-ut), ndërsa çështja e sigurisë së jetës dhe pasurisë ka qenë nën kompetencat të KFOR-it. Gjykata vendosi si në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimit duke u mbështetur në dispozitat të nenit 399.1 dhe 2, e lidhur me nenin 4.2, të LPK-së, për arsye se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesë padisë për arsye se faktet e treguara në padi dhe faktet në të cilët mbështetët kërkesë padia, qartë janë në kundërshtim me provat të cilat i kanë propozuar paditësit dhe me faktet që janë botërisht të ditura për arsye se në bazë të rregulloreve të cekura me lartë ligjeve në fuqi është botërisht i njohur fakti se Qeveria e Përkohshme e Kosovës, ka qenë e administruar nga UNMIK-u, që nga formimi i tyre dhe së zgjedhjet e para në Kosovë, janë mbajtur me dt. 28.10.2000, ndërsa ato të përgjithshme në nivel qendror janë mbajtur me dt. 17.11.2001, në kohën para formimit të tyre kur dëmi është shkaktuar siç pretendon pala paditëse ka administruar UNMIK-u, ndërsa përgjegjës për sigurimin e jetës së pasurisë ka qenë kompetencat e KFOR-it. Gjykata vendosi si në pikën 1 të dispozitivit të këtij aktgjykimit jashtë seancë duke u mbështetur në dispozitat të nenit 4.2 të LPK-së, e cila shprehimisht parasheh së gjykata vendos për kërkesë padinë në bazë të veprimeve procedurale të shkruara dhe provave të administruara në mënyrë jo të drejt për drejtë po që se kjo përcaktohet me ligj, në rastin konkret e paraparë me dispozitat të nenit 399.1 dhe 2 të LPK-së. Gjykata vendosi që secila palë ti bart shpenzimet të veta procedurale duke u mbështetur në dispozitat të nenit 452 e lidhur me nenin 463.1 të LPK-së, për arsye së pala paditëse i ka humbur në tersi kontestin ndër sa pala paditur nuk ka kërkuar-specifikuar shpenzimet e procedurës. Nga se u tha me lartë u vendos si në diapozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit, si gjykatë e shkallës së dytë, qëndrimin dhe përfundimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, e konsideron të drejtë dhe të ligjshëm, i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par.2 pikat (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe plotësisht, si dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë.

Gjykata e Apelit, vlerëson se nga ekzaminimi i aktgjykimit të ankimuar, rrjedhë se gjykata e shkallës së parë, me vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, ka vlerësuar drejtë provat dhe përmes nxjerrjes së provave, drejtë ka vërtetuar faktet që kanë rezultuar në vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, si dhe i njëjti aktgjykim përmban të gjitha arsyet vendimtare sipas nenit 160 par.4 dhe 5, dhe të njëjtat arsye të dhëna janë në harmoni të plotë lidhur me vendosjen si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi i atakuar me ankesë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të nenit 182.1 dhe 182.2 pika i) dhe j) e LPK-së, e as me zbatim të gabuar të ligjit material të parapar sipas dispozitave të nenit 184 të LPK-së për shkak se gjykata drejtë ka vërtetuar gjendjen faktike, drejtë ka zbatuar dispozitat e LPK-së, dhe drejt ka zbatuar edhe të drejtën materiale me rastin e vendosjes.

Gjithashtu nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale nga neni 182.2 pika i) dhe j) të LPK-së, sepse gjykata nuk ia ka pamundësuar asnjërës nga palët deklarin lidhur me çështjen dhe se palëve iu është mundësuar përdorimi i gjuhës së tyre në procedurë, ashtu që edhe aktgjykimi i atakuar me ankesë palës paditëse iu është dorëzuar në gjuhën e tyre amtare.

Gjykata e Apelit shqyrtoj edhe pretendimet tjera ankimore por të njëjtat nuk ishin relevante për vendosje ndryshe në këtë çështje kontestimore.

Nga arsyet e cekura si më lartë, Gjykata e Apelit në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par.1 pika (d), dhe neni 200 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3163/21, me datë 19.06.2024

Kryetari i Kolegjit-Gjyqtari
Fatmir Baloku d.v